



Syri i Vizionit

NGO "Syri i Vizionit"

Rr. Isa Demaj nr.14, 30000, Pejë, Kosovë
+381 (0)39 423 240, +377 (0)44 111 408
info@syriivizionit.org, www.syriivizionit.org

mendo globalisht, vepro lokalisht

THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT

12/SiV/2022 – Trajner/Organizatë – Për ofrimin e trajnimeve për zhvillim të biznes planeve, si dhe këshillim e montorimin në zbatimin e planeve të biznesit për 12 përfitues të granteve në kuadër të projektit "Mbështetje për Zhvillimin e Arsimit dhe Punësimin – SEED faza III" projekt i cili zbatohet nga organizatat Volkshilfe Solidaritet dhe Syri i Vizionit me financim nga Agjencia Austriake për Zhvillim - ADA.

Termet e Referencës

Shkurt 2022

Rreth organizatës Syri i Vizionit

Organizata Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në Shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë më herët që nga 1999 si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO), në komunën e Pejës.

Përgjatë viteve të fundit, OJQ "Syri i Vizionit" ka zhvilluar partneritete të shumta me një spektër të gjerë të organizatave lokale dhe ndërkombëtare, komunave dhe faktorëve tjerë aktivë në Kosovë dhe Ballkan si: Komisioni Evropian, Save the Children në Kosovë, Olof Palme International Centre, Solidar Suisse, Volkshilfe Solidaritet, ADA, USAID, KEC, KFOS, DRC, CARE International, OSCE, etj.

Informata të përgjithshme

Programi SEED faza e tretë mbështetet nga ADA dhe realizohet në dy shtete: në Kosovë dhe Serbi dhe ka për qëllim që të kontribuojë në zhvillimin strategjik të tregut të punës, një kontribut për uljen e varfërisë dhe barazinë gjinore në këto shtete. Programi tre vjeçar në Kosovë realizohet nga organizata "Syri i Vizionit" dhe fokusohet në nxitjen e partneritetit të qëndrueshëm që shtyn në krijimin e një kornize aktive të tregut të punës në nivel lokal dhe në qasjen në punësim formal. Një vëmendje e veçantë u është dhënë të rinjve dhe grave përmes: mbështetjes në punësim, lehtësimin në mes sektorit publik dhe privat, forcimit të organizatave partnere, ekspertizës dhe transferimit të njohurive, promovimin e punësimin ose vetëpunësimin në kushte të drejta pune dhe rritjes së ndërgjegjësimit për barazi gjinore.

Në të tri komunat Pejë, Gjakovë dhe Prizren, ku është paraparë realizimi i projektit, Syri i Vizionit punon ngushtë me Komunën e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Kulturës, Rinisë edhe Sportit, Zyrrat rajonale të punësimit, Zyrrat për barazi gjinore në komuna, hotelet dhe restorantet, operatorët turistik, autoritete lokale të arsimit, Inspektoratet e Edukimit, Drejtoritë e zhvillimit ekonomik, Agjencitë e Zhvillimit Rural dhe Shkollat Profesionale – në drejtimet Hoteleri dhe turizëm.

Në nivel lokal në komunat e lartcekura këta akterë do të njihen si grupi lokal për punësim. Këta akterë do të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet e projektit, duke marrë pjesë në dialog dhe punëtori që do organizohen në kudër të projektit, duke kontribuar dhe zhvilluar strategji lokale për punësimin e të rinjve dhe grave. Ndërsa, në nivel kombëtar Syri i Vizionit do të organizojë takime dhe konferenca për të koordinuar dhe adresuar punët në mes të palëve të interesuara nga niveli lokal në atë qendror.

Objektiva

Syri i Vizionit ftojnë Trajner/Organizata trajnuese profesionale në fushën e trajnimeve me përvojë (se paku 3 vjeçare) për zhvillimin e ndërmarrësisë dhe idetë e biznesit për të ngritur kapacitetet e të rinjve dhe grave për të zhvilluar idetë e tyre inovative dhe shndërruar ato në Strat-up të suksesshëm apo zhvillim të ndërmarrjeve ekzistuese.

Përfitues e këtyre trajnimeve / këshillimeve do të jenë 12 përfitues të granteve nga komunat Pejë, Gjakovë dhe Prizren, nga thirrja e cila ka pasur dy objektiva:

Pjesa 1: Zhvillimi i mëtejshëm i ndërmarrjeve të reja të themeluara në Pejë, Gjakovë e Prizren gjatë tri viteve të fundit dhe tre muajve të fundit (1 nëntor 2018 deri më 1 shtator 2021) duke ngritur kapacitetet prodhuese për të rritur punësimin për të rinjtë 15-29 vjeç dhe grave në minimum 50% për së paku 6 muaj.

Pjesa 2: Mbështetja e themelimit të ndërmarrjeve të reja inovative (start-up) të të rinjve 15-29 vjeç dhe grave në Pejë, Gjakovë dhe Prizren për të mbështetur vetëpunësimin e tyre.

Me qëllim të këshillimit dhe zhvillimit me të mirë të këtyre ideve do të organizohen trajnime para se idetë e tyre të financohen;

1. Mbajtja e trajnimit për zhvillimin e biznes ideve për start up dhe biznese ekzistuese;
2. Këshillim dhe mentorim individual gjatë zbatimit të biznes planit për të gjithë përfituesit;

Kualifikimi i nevojshëm:

- Kualifikimi i duhur në ofrimin e trajnimeve si trajner/organizatë
- Trajneri/Trajneret e propozuar të kenë përvojë dhe kualifikim në njërin nga këto fusha Menaxhim Biznese dhe Inovacion (kualifikimi Master dhe edukimi profesional/joformal në fushat e trajnimeve është përparësi);
- Përvojë e punës së paku tri (3) vjeçare në ofrimin e trajnimeve dhe realizimit të tyre që kanë të bëjnë me grupet e synuar;

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

Trajneri/Organizata e angazhuar pritet:

- Zhvillojë modulën trajnimeve për fushat e caktuara në konsultim me stafin përgjegjës të SiV-it, për rishikim dhe aprovim paraprak;
- Përgatisë materialet e nevojshme shtesë për trajnim dhe këshillim duke përfshirë prezantimin në power-point për secilin modul të trajnimit, agjendën për trajnim, si dhe pyetësorët para dhe pas trajnimit, në konsultim me stafin përgjegjës të SiV-it për rishikim dhe aprovim paraprak;
- Udhëheqë trajnimin 3 ditor me pjesëmarrjen e 12 përfitueseve, duke treguar profesionalizëm, sqaron dhe shtjellon tematikën dhe termet përkatëse në gjuhën e kuptueshme për pjesëmarrësit;
- Përgatit përfituesit që një ditë të angazhohen në hulumtim të tregut, secili përfitues në lëmin e vet
- Përgatit pjesëmarrësit që të finalizojnë biznes planet e tyre me informatat e marra nga trajnimi dhe hulumtimi i tregut, dhe ato ide prezantohen para stafit të projektit.
- Ofron këshillim dhe mentorim individual për të gjithë përfituesit gjatë zbatimit të biznes planeve përmes platformave online për një periudhë 30 ditore pas përfundimit të trajnimit.
- Përgatit një raport narrativ pasi të ketë përfunduar trajnimet dhe i gjithë angazhimi me rezultatet e arritura.

Angazhimi i Kompanisë/Organizatës:

Trajneri/Organizata do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me Syri i Vizionit-nën koordinimin e Menaxherit të Financave dhe Administratës. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument.

Detyrat	Kohëzgjatja
Përgatitja e metodologjisë së trajnimeve (Moduli/metodologjia, agjenda, pyetësorët para dhe pas trajnimit dhe materialet tjera të nevojshme)	1 ditë
Mbajtja e trajnimeve më të rinjtë dhe gratë të cilët/at janë shpallur fituese të granteve (12 përfitues) nga komunat (Pejë, Gjakovë dhe Prizren) trajnimi do organizohet me gjithë përfituesit në një lokacion të caktuar	3 ditë
Këshillim dhe mentorim individual përmes platformave online gjatë zbatimit të biznes ideve	30 ditë
Përgatitja dhe dorëzimi i raportit narrativ për punëtorin / trajnim dhe këshillim e montorim	1 ditë
Gjithsej:	35 ditë

Kushtet e Pagesës:

Pagesa e trajnerit/es/Organizatës do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të përgatitet apo leshohet nga Trajneri/Organizata për trajnimet e mbajtura. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën Euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të të gjitha trajnimeve dhe dorëzimit të raportit narrativ të aprovuar nga SiV.

Shpenzimet e mbajtjes së trajnimeve (materjalet, hapësira, pije dhe ushqimit) do t'i mbulojë organizatori.

Dokumentet dhe procedura për aplikim:

- Kopja e Diplomës Universitare e trajnerit/stafit të angazhuar në mbajtjen e trajnimeve (ndonjë Certifikatë e Lincencimit nga institucioni përgjegjës konsiderohet përparësi);
- Certifikatën e regjistrimit që dëshmon se organizata është e regjistruar
- Certifikatën apo ndonjë dokument tjetër që dëshmon se trajneri/organizata është kredibile dhe e licencuar në dhënien e trajnimeve;

- Metodologjinë e punës, duke përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të materialeve për trajnim dhe mbajtjen e trajnimeve;
- Metodologjinë e punës, duke përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të materialeve për këshillime individuale;
- Një letër motivuese ku përfshihet përvoja e punës dhe ekspertiza trajnerit/organizata në fushën e trajnimeve të tilla;
- Një planë tentativë të punës;
- Curriculum Vitae (CV) për Trajnerat e propozuar
- Propozimi financiar*
 - **Oferta financiare duhet të jetë e detajizuar për secilën punë që do të realizohet, këtu duhet të përfshihet, zhvillimin e modulit dhe materjalet e trajnimit, mbajtja e trajnimeve, shkrimi i raportit dhe*

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: office@syriivizionit.org me subjektin: Thirrje publike Trajner për Trajnime për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe zhvillim të biznes planeve. Apo edhe përmes postës në adresën e organizatës OJQ: “Syri i Vizionit”, Rr. Isa Demaj, nr. 14, 30000 Pejë, Kosovë. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **18 Shkurt 2022** (e premte), **ora 16:00**.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!